

KUR BËHENI VIKTIMË E VEPRËS PENALE?

Nëse keni pësuar dëm, duke e përfshirë lëndimin fizik, mendor, vuajtjen emocionale, humbjen materiale apo lëndimin tjetër apo kërcënimin e të drejtave dhe interesave Tuaja, si pasojë e kryerjes së veprës penale.

CILAT JANË TË DREJTAT TUAJA SI VIKTIMË E VEPRËS PENALE?

Si viktimë e veprës penale keni të drejtë të merrni pjesë në procedurën penale si i dëmtuar me përfshirje në ndjekjen penale ose për realizimin e kërkesës për dëmin pronësor-juridik. Keni të drejtë edhe për kujdes dhe vëmendje të veçantë nga ana e organeve dhe subjekteve të cilat marrin pjesë në procedurën penale, si dhe për ndihmë psikologjike dhe ndihmë tjetër profesionale dhe mbështetje nga ana e organeve, institucioneve dhe organizatave për ndihmë viktimave të veprave penale.

Policia, prokurori publik dhe gjykata veprojnë me kujdes të veçantë ndaj Jush, duke Ju dhënë këshilla për të drejtat dhe duke u kujdesur për interesat e Juaja gjatë miratimit të vendimeve për ndjekje penale dhe gjatë marrjes së veprimeve në procedurën penale.

KUR BËNI PJESË NË KATEGORITË E CENUARA TË VIKTIMAVE?

Në kategoritë e cenuara të viktimave bëni pjesë nëse jeni viktimë në moshë nën 18 vjet, nëse me dhënien e dëshmisë do ta ekspozonit vetveten ose personin e afërt në rrezik serioz për jetën, shëndetin ose integritetin fizik ose nëse jeni viktimë veçanërisht të ndjeshme për shkak të moshës, natyrës dhe pasojave të veprës penale, invaliditetit fizik ose psikik, gjendjes shëndetësore, të kaluarës

shoqërore dhe kulturore, rrethanave familjare, bindjeve fetare e të ngjashme.

Në këto raste prokuroria dhe gjykata duhet të përkujdesen t'Ju sigurojnë masa të posaçme të mbrojtjes së procesit.

ÇKA NËSE JENI VIKTIMË E VEPRAVE PENALE KUNDËR LIRISË GJINORE DHE MORALIT GJINOR, NJERËZISË DHE TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE?

Nëse jeni viktimë e veprave penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, përveç të drejtave që i kanë viktimat e veprave të tjera penale, Ju i keni edhe këto të drejta:

- Para hetimit të bisedoni me këshilltar pa pagesë;
- Të merreni në pyetje nga personi i gjinisë së njëjtë në polici dhe në prokurorinë publike;
- Të mos përgjigjeni në pyetjet të cilat kanë të bëjnë me jetën Tuaj personale, të cilat nuk janë të lidhura me veprën penale;
- Të kërkonti marrjen në pyetje me ndihmën e mjeteve vizuale - të zërit, si dhe
- Të kërkonti përjashtimin e publikut nga seanca kryesore.